



V E N D I M

K.P.P. 440/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Arian_A” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-52000-02-27-2018, me objekt: “Blerje lende djegese per ngrohje (pelet) per nevoja te Spitalit Rajonal Diber per vitin 2018”, me fond limit 6.000.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.

Ankimues:

“Arian_A” sh.p.k
Lagja “Gjok Doci”, Peshkopi

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber
Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.02.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-52000-02-27-2018, me objekt: “*Blerje lende djegese per ngrohje (pelet) per nevoja te Spitalit Rajonal Diber per vitin 2018*”, me fond limit 6.000.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber.

II.2. Në datën 17.04.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|---------------------|------------------------------|
| 1. “Arian_A” sh.p.k | 5.146.196 lekë, skualifikuar |
| 2. “IGMA” sh.p.k | 5.988.300 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik “Arian_A” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“Nuk ka paraqitur specifikimet teknike te kerkuara sipas DST-ve, por ka paraqitur vetem 3 kaldaja. Ndersa ato specifikime teknike qe ka paraqitur nuk jane ne perputhje me sa kerkuar nga AK ne DST te procedures..”

II.3. Në datën 23.04.2018 operatori ekonomik “Arian_A” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“Në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara nga ana juaj ju informojmë se ne kemi paraqitur 3 kaldaja 500 kw, të cilat i kemi bashkëngjitur edhe faturat e blerjes dhe specifikimet teknike të përkthyer dhe të noterizuara, specifikime këto të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e AK për realizimin e shërbimit të kërkuar në prokurim [...]. Kaldajat e paraqitura nga ana jonë kryejnë të njëjtin funksion të shërbimeve të kërkuara nga ju në këtë procedurë.”

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 271/1 prot., datë 30.04.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën si vijon:

“Përsa i përket ankesës së operatorit ekonomik “Arian_A” sh.p.k në lidhje me arsyen e skualifikimit për shkak se: “Nuk ka paraqitur specifikimet teknike të kërkuara sipas DST-ve, por ka paraqitur vetëm 3 kaldaja. Ndërsa ato specifikime teknike që ka paraqitur nuk janë në përputhje me sa kërkuar nga AK në DST të procedurës”, në DST, në specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta të kualifikimit kërkohet:

1. Te kete gjendje 3 (tre) copë kaldaja me pelet (me fuqi 480 – 500 Kw) me keto te dhena:

○ Tipi	350/440
○ Fuqia min/max e punes	392 - 530 kw
○ Fuqia termike nominale	500 kë
○ Fuqia termike e kthyer	459 kë
○ tensioni i punes (elektrik)	380 v
○ Fuqia motorrike	1100 w
○ Rendimenti	87 %
○ Presioni i ujit	1,5 - 3,8 bar
○ Lartesia	2750 mm
○ Gjatesia	2180 mm
○ Gjeresia	1720 mm
○ Pesha	1855 kg
○ Kapaciteti i ditor i silozit	1,5 m3

2. Te kete gjendje 3 (tre) bruciator me pelet me keto karakteristika teknike:

○ modeli	BP 500 kë
○ fuqia min/max ne kë	400-550 kë
○ tensioni i punes (elektrik)	220 V
○ fuqia e motorit te ventilatorit	190 W

- Kandelet e ndezjes 2 cope 750 W
 - Rendimenti 85 %
 - dimensionet 360 x 420 x 1200 mm
 - shneku me diameter 110 mm
 - fuqia e motorit te shnekut 180 W
 - dimensionit tubit te shkarkimit 75 mm
3. Operatori ekonomik qe kualifikohet duhet ti kete te montuara paisjet djegese te peletit nga data e fillimit te kontrates deri ne perfundimin e saj.
4. Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësat/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose në kontrata qeraje noteriale.
- Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimit ose kontratë shitblerje noteriale.
 - Për paisjet teknike të marra me qera duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit (akt çdoganimit ose kontratë shitblerje).
- Autoriteti kontraktor, ka të drejtën të kryejë verifikimin fizik të kaldajave dhe djegësave (bruciatorët), me ose pa lajmërim paraprak, përpara vlerësimit të ofertave nga KVO.
 - Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë si dhe të përcaktojë saktë vendndodhjen e pajisjeve teknike, të cilat duhet të jenë brenda teritorit të Republikës së Shqipërisë.
 - Ofertuesit duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë që kaldajat dhe djegësat (bruciatorët) e propozuar, nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër.
 - Ofertuesi, me një deklaratë nga ana e tij të marrë përsipër motimin e kaldajave dhe djegësave (bruciatorëve) menjëherë mbas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

Pra ankesa juaj nuk qëndron.

Gjithashtu nga dokumentacioni i paraqitur në SPE nga ana juaj rezulton se keni paraqitur:

1.Pro-invoice no.16004, me përshkrim pellet boiler, lëshuar nga shoqëria ABC Dojchinovski ltd në Maqedoni.

2.Faturë tatimore nr.03102016/02,me përshkrimin kaldajë 500kw dhe 300 kw, lëshuar nga Media Marketing me seli në Kosovë.

Këto fatura nuk janë shoqëruar me fletët e zhdoganimit të Republikës së Shqipërisë, sic përcaktohet në DST.

Pajisjet teknike (kaldajat dhe djegësat/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose me kontrata qiraje noteriale. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë akt zhdoganimit ose kontratë shitblerje noteriale. Për pajisjet teknike të marra me qira duhet të paraqitet kontratë qiraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit (akt zhdoganimit) ose kontratë shitblerje).

Juve keni paraqitur deklaratë doganore R 551 datë 02.07.2016 me emërtim të mallit kaldaja shtëpiake, por këto kaldaja nuk plotësojnë kriterin e vendosur në DST.

Gjithashtu nga ana juaj nuk janë paraqitur:

Të ketë në gjendje 3 (tre) bruciatore me pelet me këto karakteristika teknike:

modeli	BP	500 kw
fuqia min/max ne kw	400-550	kw
tensioni i punes (elektrik)	220	V
fuqia e motorit te ventilatorit	190	W
Kandelet e ndezjes 2 cope	750	W
Rendimenti	85	%
dimensionet	360 x 420 x 1200	mm
shneku me diameter	110	mm
fuqia e motorit te shnekut	180	W
dimensioni tubit te shkarkimit	75	mm

sic kërkohet në specifikimet teknike dhe në kriteret e vecanta të kualifikimit, duke mos plotësuar kërkesën për kualifikim.

II.5. Në datën 08.05.2018 operatori ekonomik “Arian_A” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu, lidhur me përgjigjen e autoritetit kontraktor ankimuesi ka sqaruar:

“Përsa i përket pikës së parë të vendimit të personit përgjegjës për shqyrtimin e ankesës, ju bëjmë me dije se kaldajat tona kanë të njëjtën fuqi dhe funksionalitet të kërkuar nga AK por nuk i kanë specifikimet teknike të kërkuara nga AK pikë për pikë pasi nuk janë kaldajat tona ato që AK ka të instaluar por janë kaldajat e OE të shpallur fitues nga ana e AK për procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.

Përsa i përket pikës së dytë të vendimit të personit përgjegjës për shqyrtimin e ankesës, ju bëjmë me dije se për kaldajat e paraqitura në procedurën e prokurimit në fjalë, disponojmë dhe ju vëmë në dispozicion deklaratën doganore R1292 nr 625 datë 14.12.2016 ku përshkruhet saktësisht fatura e blerë me faturë tatimore nr.03102016/02, me përshkrimin kaldajë 500 kw dhe 300 kw sic përcaktohet në DST.”

II.6. Në datën 21.05.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 879/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 314/1 prot., datë 18.05.2018, me objekt: “Informacion...”, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Arian_A” sh.p.k për skualifikimin e tij të padrejtë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Sipas njoftimit elektronik të datës 17.04.2018 rezulton se shoqëria “Arian_A” sh.p.k është skualifikuar pasi:

“Nuk ka paraqitur specifikimet teknike të kërkuara sipas DST-ve por ka paraqitur vetëm 3 kaldaja. Ndersa ato specifikime teknike që ka paraqitur nuk janë në përputhje me sa kërkuar nga AK në DST te procedures”.

III.1.2. Lidhur me këto arsye skualifikimi, në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknike profesional” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar që ofertuesit të disponojnë kapacitetet si vijon:

- “Te ketë gjendje 3 (tre) copë kaldaja me pelet (me fuqi 480 – 500 Kw) me keto të dhena:

○ Tipi	350/440
○ Fuqia min/max e punës	392 - 530 kw
○ Fuqia termike nominale	500 kë
○ Fuqia termike e kthyer	459 kë
○ tensioni i punës (elektrik)	380 v
○ Fuqia motorrike	1100 W
○ Rendimenti	87 %
○ Presioni i ujit	1,5 - 3,8 bar
○ Lartësia	2750 mm
○ Gjatesia	2180 mm
○ Gjeresia	1720 mm
○ Pesha	1855 kg
○ Kapaciteti i ditor i silozit	1,5 m3

- Te ketë gjendje 3 (tre) bruciator me pelet me keto karakteristika teknike:

○ modeli	BP 500 kw
○ fuqia min/max në kë	400-550 kw
○ tensioni i punës (elektrik)	220 V
○ fuqia e motorit të ventilatorit	190 W
○ Kandelet e ndezjes 2 cope	750 W
○ Rendimenti	85 %
○ dimensionet	360 x 420 x 1200 mm
○ shneku me diameter	110 mm
○ fuqia e motorit të shnekut	180 W
○ dimensionit tubit të shkarkimit	75 mm

- *Operatori ekonomik qe kualifikohet duhet ti kete te montuara paisjet djegese te peletit nga data e fillimit te kontrates deri ne perfundimin e saj.*
- *Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësat/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose në kontrata qeraje noteriale.*
 - *Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimi ose kontratë shitblerje noteriale.*
 - *Për paisjet teknike të marra me qera duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit (akt çdoganimi ose kontratë shitblerje).*
- *Autoriteti kontraktor, ka të drejtën të kryejë verifikimin fizik të kaldajave dhe djegësave (bruciatorët), me ose pa lajmërim paraprak, përpara vlerësimit të ofertave nga KVO.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë si dhe të përcaktojë saktë vendndodhjen e pajisjeve teknike, të cilat duhet të jenë brenda teritorit të Republikës së Shqipërisë.*
- *Ofertuesit duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë që kaldajat dhe djegësat (bruciatorët) e propozuar, nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër.*
- *Ofertuesi, me një deklaratë nga ana e tij të marrë përsipër motimin e kaldajave dhe djegësave (bruciatorëve) menjëherë mbas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.”*

III.1.3. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Arian_A” sh.p.k konstatohet se në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik kundërshtohet arsyeja e skualifikimit lidhur me pajisjet kaldaja dhe nuk është dhënë asnjë argument apo kundërshtim lidhur me arsyen e skualifikimit përse i përket kapacitetit teknik të kërkuar nga autoriteti kontraktor që subjekti të kete gjendje 3 (tre) bruciator me pelet me karakteristikat e përcaktuara në kriteret kualifikuese, (për të cilën rezulton se është skualifikuar subjekti në fjalë, përveçse për kaldajat).

III.1.4. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i ankesës i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, një prej arsyeve të skualifikimit nuk është ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në Komisionin e Prokurimit Publik.

III.1.5. Në nenin 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 , 5, 6 dhe 7 parashikohet se:

“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji” (pika 2).

“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës (pika 5).”

“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor” (pika 6).

“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkëljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme” (pika 7).

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Ariana_A” sh.p.k, nuk janë ndjekur shkallët e ankimimit lidhur me arsyen e skualifikimit për pajisjet bruciatores.

Në këto kushte, duke qënë se aktualisht kanë përfunduar afatet e ankimimit në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, rrjedhimisht arsyet e skualifikimit të cilat nuk janë ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në KPP, nuk mund të merren në shqyrtim nga ky komision e për rrjedhim ai rezultoi të ngelet i skualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Edhe në hipotezën se pretendimet e tjera të paraqitura pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP do të qëndronin, operatori ekonomik ankimesi nuk do të ndryshonte gjendjen e tij faktike e juridike, por do të mbetej sërish i skualifikuar nga procedura në fjalë, për shkak të skualifikimit të bëra më dije në datën 17.04.2018, të cilat nuk janë ankimuar pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP, në respekt të shkallëve të ankimimit.

Përsa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “Arian_A” sh.p.k, përse i përket skualifikimit të tij, nuk do të merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Arian_A” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-52000-02-27-2018, me objekt: “Blerje lende djegese per ngrohje (pelet) per nevoja te Spitalit Rajonal Diber per vitin 2018”, me fond limit

6.000.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 879 Protokolli,

Datë 08.05.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

